

DEKRET
Nr.295, datë 15.9.1992

PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE
PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PERSONAVE TË TRETË

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

KREU I
SIGURIMI I DETYRUESHËM

Neni 1

Në kuptim të këtij dekreti:

- a) Mbjtësi i mjetit motorik është personi që ka kontrollin aktual të mjetit. Ai mund të jetë pronari, nëndorësi ose shoferi i mjetit motorik.
- b) Mjet motorik është ai që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anën e fuqisë së tij motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjetet motorike do të quhet edhe rimorkiot ose gjysëmrimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.
- c) Siguruesi është shoqëria e sigurimit e autorizuar nga organi kompetent për të ushtruar sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë.
- ç) Polica ose certifikata e sigurimit është dokumenti me anën e të cilit mbajtësi i mjetit motorik provon lidhjen e kontratës së sigurimit të tij për përgjegjësinë ndaj personave të tretë.

Neni 2

Mbjtësi i një mjeti motorik detyrohet të lidhë, me një sigurues të autorizuar, një kontratë për sigurimin e përgjegjësisë së tij ndaj personave të tretë për mbulimin e vdekjes, të dëmtimit të shëndetit dhe të dëmeve pasurore, të shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik, duke përfshirë dëmet në mallrat gjatë transportit.

Neni 3

Sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë nuk zbatohet për kategori të veçanta mjetesh motorike të ushtrisë, të cilat përcaktohen me rregullore të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe atij të Financave dhe Ekonomisë.

Neni 4

Mbjtësi i mjetit motorik detyrohet ta mbajë gjithmonë me vete policën ose certifikatën e sigurimit dhe t'ua paraqesë, bashkë me dokumentet e tjera të qarkullimit rrugor, sa herë që i kërkohet.

Neni 5

Siguruesi e pajis mbajtësin e mjetit motorik, në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit, me një shenjë dalluese, e cila mban emrin e siguruesit, numrin e targës së regjistrimit të mjetit

motorik, dhe afatin e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.

Forma e shenjës dalluese, mënyra dhe vendi i vendosjes së saj përcaktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 6

Regjistrimi i mjeteve motorike mund të bëhet vetëm nëse organit kompetent i paraqitet polica e sigurimit.

Neni 7

Personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit nuk ka të drejtë të paraqesë kërkesë për shpërblimin e dëmit sipas dispozitave të këtij dekreti.

Neni 8

Siguruesi që ushtron veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, detyrohet të bëjë sigurimin e tyre për përgjegjësinë ndaj personave të tretë sipas dispozitave të këtij dekreti.

Neni 9

Kërkesa për lidhjen e kontratës së sigurimit mund të refuzohet nga siguruesi:

- Kur kërkuuesi nuk ka paguar primin e sigurimit ose këstin e tij të parë;
- Kur kërkuuesi e ka lidhur kontratën e sigurimit, por ajo është anuluar nga siguruesi për mashtrim, paraqitjen e fakteve në mënyrë mashtruese në kohën e lidhjes së kontratës ose mospagimin e këstit vijues të primit të sigurimit. Në këto raste, siguruesi nuk mund të refuzojë kërkesën për lidhjen e kontratës së sigurimit pas kalimit të një afati 1-vjeçar nga koha e anulimit të kontratës së mëparshme.

Neni 10

Përgjegjësia e siguruesit nuk mund të jetë më e vogël se vleftat e përcaktuara në listën e vleftave minimale të shumës së siguruar, që është pjesë përbërëse e këtij dekreti.

Vlefta minimale të shumës së siguruar, të përcaktuara sipas grupeve të mjeteve motorike për një aksident, për një person dhe për dëme pasurore, mund të ndryshohen me dispozita të Këshillit të Ministrave, nëse kjo është e nevojshme për të realizuar mbrojtje të mjaftueshme të personave të dëmtuar dhe nëse vërtetohen ndryshime të kushteve ekonomike.

Neni 11

Në rastet kur vlefta e përcaktuar sipas nenit 10 të këtij dekreti është e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha dëmet e shkaktuara në një aksident, atëherë do tu jepet përparësi rasteve të vdekjes dhe të dëmtimeve të shëndetit.

Në qoftë se ka më shumë se një person që ka pësuar dëmtime të shëndetit dhe dëmshpërblimi total e kalon vleftën sipas nenit 10 të këtij dekreti, të drejtat e personave të dëmtuar në lidhje me siguruesin do të zvogëlohen në mënyrë përpjestimore.

Siguruesi që i ka paguar një personi të dëmtuar një vleftë më të madhe se ajo që i takonte, lidhur me dëmshpërblimin e zvogëluar në mënyrë përpjestimor, sepse nuk kishte dijeni për personat e tjerë të dëmtuar, mbetet i detyruar ndaj atyre personave të tjerë deri në vleftën sipas nenit 10 të këtij dekreti.

Neni 12

Kur një institucion që kryen sigurimin e humbjes së aftësisë për punë dhe pensionit, bën një kërkesë për shpërblimin e dëmit, siguruesi detyrohet të paguajë, në masën që i siguruari i tij është përgjegjës për dëmin, shpenzimet për trajtimin mjekësor dhe shpenzime të tjera, në përputhje me rregullat për sigurimin e humbjes së aftësisë për punë dhe pensionit, që do të thotë që siguruesi detyrohet të paguajë vleftën përpjestimore të kontributit për sigurimin e humbjes së aftësisë për punë dhe për pensionin.

Vlefta përpjestimore e kontributit për sigurimin e humbjes së aftësisë për punë dhe për pensionin përcaktohet në vleftë të kapitalizuar, në lidhje me periudhën e mbetur të punës dhe të moshës së një personi fizik, e cila kërkohet për të arritur pensionin e pleqërisë.

Neni 13

Personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë drejtpërdrejt nga siguruesi, brenda kufijve të përgjegjësisë së tij sipas kontratës së sigurimit, shpërblimin e dëmit.

Siguruesi nuk ka të drejtë t'i paraqesë kundërshtime personit të dëmtuar lidhur me kërkesën e tij për shpërblimin e dëmit, edhe në ato raste kur i siguruari nuk i ka plotësuar detyrimet e tij sipas kontratës së sigurimit.

Neni 14

Siguruesi që ka paguar shpërblimin e dëmit, ka të gjitha të drejtat e personit të dëmtuar kundër personit përgjegjës për dëmin, në vleftën e dëmshpërblimit të paguar, shpenzimeve të kryera dhe interesit, në ato raste kur sipas kontratës së sigurimit nuk rezulton asnjë përgjegjësi për të.

Neni 15

Në qoftë se mjeti motorik, gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, kalon në pronësinë e një personi tjetër, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga kontrata e sigurimit kalojnë te pronari i ri deri në përfundimin e periudhës së sigurimit në vazhdim.

Neni 16

Primet e sigurimit dhe ndryshimet e tyre caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Kushtet e kontratës së sigurimit dhe mënyra e llogaritjes së primit të sigurimit, i paraqiten për miratim ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, i cili dhe publikon rregullat lidhur me zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike.

KREU II FONDI I KOMPENSIMIT

Neni 17

Personi, të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit motorik, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga fondi i kompensimit, deri në vleftat minimale të shumës së siguruar, në qoftë se:

- a) mjeti motorik, me të cilin u shkaktua dëmi, nuk mund të identifikohet;
- b) mbajtësi i mjetit motorik, me të cilin u shkaktua dëmi, nuk është i siguruar sipas

dispozitave të këtij dekreti;

c) mjeti motorik, i identifikuar ose jo, ishte i vjedhur ose i grabitur nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit;

ç) shpërblimi i dëmit nuk mund të paguhet nga siguruesi për shkak të falimentimit të tij.

Neni 18

Nga fondi i kompensimit paguhen:

a) Në rastin e përmendur në nenin 17, shkronja "a" - vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore, që e kalojnë vleftën 25.000 lekë, duke përjashtuar dëmin e shkaktuar mjetit motorik;

b) në rastet e përmendura në nenin 17, shkronja "b", "c" dhe "ç" - vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëme pasurore, duke përfshirë edhe dëmin e shkaktuar mjetit motorik.

Neni 19

Personit të dëmtuar i paguhet dëmshpërblimi nga fondi I kompensimit deri në masën, në të cilën ai nuk ka mundësi ta përfitojë nga sigurimet shoqërore ose nga ndonjë sigurues tjetër, me të cilin mund të ketë lidhur kontratë sigurimi për të përfituar dëmshpërblim.

Neni 20

Neni 17 i këtij dekreti zbatohet edhe për një person të huaj, të cilit i është shkaktuar një dëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur ligji i vendit, shtetësinë e të cilit mban personi i huaj, nuk lejon që shtetasit shqiptarë të dëmshpërblehen në rastet analoge.

Neni 21

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, me akt të veçantë normativ, përcakton mënyrën e financimit të fondit të kompensimit.

KREU III BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMIT

Neni 22

Byroja Shqiptare e Sigurimit themelohet nga siguruesit që ushtrojnë sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë.

Neni 23

Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen funksionet e përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë.

Byroja Shqiptare e Sigurimit përfaqëson siguruesit shqiptarë në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të sigurimit.

Neni 24

Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen administrimin e fondeve të kompensimit.

Pagesat e dëmeve mund t'i ngarkohen për t'i kryer një siguruesi që është anëtar i Byrosë

Shqiptare të Sigurimit.

Neni 25

Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen edhe veprimtari me interes të përgjithshëm mbi statistikën, informacionin dhe kualifikimin, lidhur me sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj personave të tretë.

Neni 26

Byroja Shqiptare e Sigurimit është person juridik.
Organizimi dhe veprimtaria e Byrosë Shqiptare të Sigurimit Miratimi i Statutit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit bëhet nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

KREU IV SIGURIMI I DETYRUESHËM PËR MBAJTËSIT E MJETEVE MOTORIKE, ME TARGË REGJISTRIMI TË HUAJ

Neni 27

Çdo person që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet motorik me targë regjistrimi të huaj, është i detyruar të ketë një certifikatë të vlefshme të sigurimit për përgjegjësinë ndaj personave të tretë (kartoni jeshil), e cila është e pranueshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Kur një mjet motorik me targë regjistrimi të huaj hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore të kufirit kontrollojnë nëse mjeti motorik plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 27 të këtij dekreti.

Neni 29

Me certifikatë të vlefshme sigurimi (kartoni jeshil), siç përmendet në nenin 27 të këtij dekreti, do të kuptohet dokumenti, vlefshmëria e të cilit njihet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

Pranimi i vlefshmërisë së këtij dokumenti do të bëhet vetëm nga Byroja, duke informuar për këtë edhe organet qendrore të doganës dhe të kontrollit të qarkullimit rrugor.

Pranimi i vlefshmërisë së certifikatës të sigurimit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit jep garanci për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike me targë regjistrimi të huaj.

Neni 30

Personat që nuk kanë dokumentet e treguara në nenin 27 të këtij dekreti, duhet që në kufi të lidhin kontratë sigurimi për përgjegjësinë ndaj personave të tretë me një sigurues vendas.

Neni 31

Personi, të cilit i shkaktohet një dëm në një mjet motorik me targë regjistrimi të huaj dhe që është i pajisur me dokumentin e treguar në nenin 27 të këtij dekreti, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

Neni 32

Për dëmet e shkaktuara nga mjetet motorike me targë regjistrimi të huaj, të cilat janë siguruar nga një sigurues vendas, dëmshpërblimi bëhet nga siguruesi vendas sipas dispozitave të këtij dekreti, që janë të vlefshme për mjetet motorike me targë regjistrimi shqiptare.

Neni 33

Personit të dëmtuar nga përdorimi i një mjeti motorik me targë regjistrimi të huaj, mbajtësi i të cilit nuk është i siguruar, i shpërblehen dëmet e shkaktuara sipas dispozitave të këtij dekreti mbi fondin e kompensimit.

KREU V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 34

Përdorimi ose lejimi i përdorimit të një mjeti motorik nga mbajtësi i tij, pa lidhur më parë një kontratë sigurimi për përgjegjësinë ndaj personave të tretë, ose kur kjo kontratë nuk ekziston më, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 10.000 deri në 35.000 lekë.

Neni 35

Në rastet kur organet e kontrollit të qarkullimit rrugor konstatojnë mungesën e policës ose të certifikatës së sigurimit, bëjnë bllokimin e menjëhershëm të mjetit motorik dhe mbajnë proces-verbalin përkatës, të cilin ia paraqesin organit kompetent të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative.

Neni 36

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të përcaktuara në nenin 34 të këtij dekreti bëhet nga organet e kontrollit të qarkullimit rrugor.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, marrja e vendimeve, ankimi dhe ekzekutimi i tyre bëhen sipas dispozitave përkatëse të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 37

Mbajtësi i mjetit motorik kryen kundërvajtje administrative që gjobiten në vend, në qoftë se:

- a) nuk mban me vete dhe nuk paraqet policën ose certifikatën e sigurimit, kur kjo i kërkohet nga organet e kontrollit të qarkullimit rrugor;
- b) nuk mban shenjën dalluese në mjetin e tij motorik.

Kundërvajtjet administrative të mësipërme dënohen secila me 200 lekë gjobë në vend nga organet e kontrollit të qarkullimit rrugor.

Neni 38

Ministri i Rendit Publik dhe ministri i Financave dhe i Ekonomisë, përcaktojnë rregullat dhe kriteret e vendosjes së gjobave, sipas llojit të mjeteve motorike, për kundërvajtjet administrative të përcaktuara në nenin 34 të këtij dekreti.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 39

Deri në themelimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit sipas dispozitave të këtij dekreti, funksionet e saj kryhen nga Instituti i Sigurimeve.

Neni 40

Në dekretin nr.164, datë 3.4.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të urdhërave", në nenin 1, në paragrafin e parë hiqet fjala "automjete" dhe paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 41

Institucioni i Sigurimeve do të kryejë funksionet e Byrosë Shqiptare të Sigurimit sipas nenit 39 të këtij dekreti, që nga dita e miratimit të dekretit.

Neni 42

Ky dekret hyn në fuqi më 1.1.1993.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

LISTA E VLEFTAVE MINIMALE TË SHUMËS SË SIGURUAR

1. Vleftat minimale të shumës së siguruar për:
- motoçikletat dhe biçikletat me motor;
 - autoveturat me kapacitet deri në 9 vende (pa vendin e shoferit)
 - kamionët, rimorkiot dhe gjysërrimorkiot për transportin e mallrave dhe udhëtarëve si dhe për
 - mjetet motorike të punës;
- janë si më poshtë
- a) për një aksident në të cilin dëmtohen disa persona.....50.000.000 lekë
 - b) për një person.....20.000.000 lekë
 - c) për dëme pasurore.....5.000.000 lekë
2. Vleftat minimale të shumës së siguruar për:
- autobusët
 - mjetet motorike që përdoren për garat sportive;
- janë si më poshtë:
- a) për një aksident në të cilin dëmtohen disa persona.....150.000.000 lekë
 - b) për një person.....20.000.000 lekë
 - c) për dëme pasurore.....10.000.000 lekë

